



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:224689

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753525

KPPP.nr.1689/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.L PALLATI I RINISË SH.A, me seli në Prishtinë, me adresë rr. “Luan Haradinaj” p.n, me NRB: 810962052, kundër debitorit Prime Education Sh.P.K., tani Prime College Sh.P.K., me adresë në Prishtinë, me NUI: 810073734, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.266/2023 të datës 06.10.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit Prime Education Sh.P.K., tani Prime College Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.266/2023 të datës 06.10.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.266/2023 të datës 06.10.2023, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë faturës nr.22-SHV04-001-59 të datës 19.01.2022, faturës nr. SHV04-001-284 të datës 04.02.2022, faturës nr.22-SHV04-001-441 të datës 01.03.2022, faturës nr.22-SHV04-001-631 të datës 20.04.2022, faturës nr.22-SHV04-001-709 të datës 11.05.2022, faturës nr.22-SHV04-001-819 të datës 09.06.2022, faturës nr.22-SHV04-001-920 të datës 12.07.2022, faturës nr.22-SHV04-001-1018

të datës 08.08.2022, faturës nr.22-SHV04-001-1119 të datës 01.09.2022, faturës nr.22-SHV04-001-1220 të datës 03.10.2022, faturës nr.22-SHV04-001-1321 të datës 01.11.2022, faturës nr.22-SHV04-001-1443 të datës 02.12.2022, faturës nr.22-SHV04-001-66 të datës 18.01.2023, faturës nr.23-SHV04-001-190 të datës 10.02.2023, faturës nr.23-SHV04-001-306 të datës 01.03.2023, dhe faturës nr.22-SHV04-001-422 të datës 03.04.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat e lartpërmendura, t'ia paguajë kreditorit shumën e mbetur të papapaguar në vlerë prej 16,766.65 Euro, me kamatvonesë prej 8 %, sipas LMD-së, nga dita e propozimit për përmburim deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e përmburimit, nën kërcënim të përmburimit të dhunshëm.

Kundër urdhrimit të Përmburuesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se urdhri përmburimor është lëshuar pa u vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike sa i përket detyrimit të debitorit. Më tej ka theksuar se kreditori me debitorin ka pasur marrëdhënie të shkëlqyera bashkëpunimi, dhe se kreditori bazuar në kërkesën nga debitori, i ka lëshuar hapësirën për shfrytëzim me qera, në të cilën debitori ka bërë investime mbi 10.000 euro të cilën nuk ia kanë pranuar. Në ditën kur ka qenë e caktuar të bëhet akreditimi dhe ri akreditimi i Prime College, kreditori ka bërë mbylljen e hapësirës dhe i ka shkaktuar debitorit dëme në vlerë prej 12,000.00 Euro, ku kjo ka sjellur probleme të mëdha dhe humbjet janë më të mëdha se vlera e kërkuar nga kreditori për pagesë. Ka shtuar se debitori ka bërë marrëveshje paraprake për ri programim për shlyerjen e borxhit dhe vazhdimin e shfrytëzimit me qera të hapësirës në bazë të kontratës, ndërsa kreditori pa paralajmërim ka bërë mbylljen dhe largimin nga hapësirat shfrytëzuese. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet kundërshtimi i debitorit, ndërsa urdhri për përmburim të lihet jashtë fuqisë, si dhe të anulohen veprimet e gjertanishme të Përmburuesit Privat.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, pasi që me rastin e dorëzimit të propozimit për lejimin e përmburimit në bazë të dokumentit të besueshëm, kreditori i ka dorëzuar tek Përmburuesi Privat të gjitha faktet dhe provat origjinale, për të dëshmuar se debitori i ka borxh kreditorit shumën prej 16,766.65 Euro me TVSH/bruto, plus kamatvonesën prej 8 %, sipas LMD-së. Më tej ka theksuar se debitori të gjitha faturat i ka pranuar për çdo muaj, duke i nënshkruar dhe vulosur, dhe me këto veprime debitori e ka pranuar se i ka borxh kreditorit. Ka shtuar se kreditori në bazë të nenit 3 të marrëveshjes për ri programimin e borxhit, ka qenë i obliguar për inicim të procedurës përmburimore për shkak të

mos zbatimit të marrëveshjes nga ana e debitorit. Kreditori e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit edhe sa i përket pretendimit të debitorit se i njëjti ka investuar në hapësirën afariste në shumën prej 10,000.00 Euro, pasi që ky fakt nuk ekziston, ngase në bazë të kontratës për qiranë, nuk është e lejuar nga kreditori/qiradhënësi, që pala qiramarrëse/debitori të bëjë çfarëdo ndryshime apo shtesa në hapësirën afariste, pa marrë pëlqim paraprak nga qiradhënësi. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet në tërësi si i pabazuar, dhe të lihet në fuqi urdhri për përmbarim i Përmbaruesit Privat, si dhe në emër të garancionit për ankesë të paguajë shumën e borxhit prej 16,766.65 Euro me TVSH/bruto, me kamatëvonesë prej 8 %, nga dita e dorëzimit të faturës.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme faturën nr.22-SHV04-001-59 të datës 19.01.2022, faturën nr. SHV04-001-284 të datës 04.02.2022, faturën nr.22-SHV04-001-441 të datës 01.03.2022, faturën nr.22-SHV04-001-631 të datës 20.04.2022, faturën nr.22-SHV04-001-709 të datës 11.05.2022, faturën nr.22-SHV04-001-819 të datës 09.06.2022, faturën nr.22-SHV04-001-920 të datës 12.07.2022, faturën nr.22-SHV04-001-1018 të datës 08.08.2022, faturën nr.22-SHV04-001-1119 të datës 01.09.2022, faturën nr.22-SHV04-001-1220 të datës 03.10.2022, faturën nr.22-SHV04-001-

1321 të datës 01.11.2022, faturën nr.22-SHV04-001-1443 të datës 02.12.2022, faturën nr.22-SHV04-001-66 të datës 18.01.2023, faturën nr.23-SHV04-001-190 të datës 10.02.2023, faturën nr.23-SHV04-001-306 të datës 01.03.2023, dhe faturën nr.22-SHV04-001-422 të datës 03.04.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula dhe nënshkrimi i debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1689/23, me datë 24.05.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.